




Vaksinimi Shpëton Jetë  
Vaccination saves lives



Edhe në rast   
se jeni vaksinuar  
me një ose dy doza,  
ju duhet të vazhdoni  
të ndiqni udhëzimet  
e tjera për mbrojtjen  
sikurse kërkohet

# COVID-19

# vaksinimi

## Një udhëzues për personat madhorë

I rishikuar Maj 2021 - Albanian



GIG  
CYMRU  
NHS  
WALES



# Përmbajtja

-  Çfarë është COVID-19 apo Koronavirus? 3
-  Pse duhet të marr vaksinën kundër COVID-19? 3
-  A janë të sigurta vaksinat? 4
-  A mund t'u besojmë vaksinave, të cilat janë zhvilluar kaq shpejt? 5
-  A do të më mbrojë vaksina? 5
-  A kam të drejtë të marrë vaksinën kundër COVID-19? 6
-  Unë jam shtatzënë, a mund ta marr vaksinën? 6
-  A mund të vaksinohem nëse jam duke ushqyer me gji? 7
-  A do të ndikojë vaksina në pjellorinë time? 7
-  Kush nuk mund ta marrë vaksinën? 7
-  A ka vaksina efekte anësore? 8
-  A mund të marr COVID-19 nga vaksina? 10
-  Çfarë duhet të bëj? 10
-  Çfarë duhet të bëj nëse nuk ndihem mirë ditën e takimit tim të ardhshëm? 10
-  A duhet t'i ndjek ende udhëzimet edhe nëse jam vaksinuar? 11
-  Më shumë informacion 12

## Çfarë është COVID-19 apo Koronavirusi?

COVID-19 shkaktohet nga një koronavirus i ri i quajtur SARS-CoV-2. Për herë të parë u identifikua në fund të vitit 2019. Është shumë infektive dhe mund të shkaktojë sëmundje të rënda të frymëmarrjes. Shumë njerëz të infektuar mund të mos kenë simptoma ose vetëm simptoma të lehta. Zakonisht ato fillojnë me kollë, ethe, dhimbje koke dhe humbje të shijes ose nuhatjes.

Disa njerëz do të ndjehen shumë të lodhur, me dhimbje të muskujve, dhimbje fyti, diarre, të vjella, ethe ose konfuzion. Një numër i vogël i njerëzve sëmuren rëndë, gjë që mund të kërkojë shtrim në spital ose pranim në kujdesin intensiv.

Në përgjithësi, pak më pak se 1 në 100 njerëz të infektuar do të vdesin nga COVID-19. Sëmundja e rëndë është e rrallë tek fëmijët, por rreziku rritet me moshën. Për shembull, rreziku mesatar i vdekjes nga COVID-19 për një person ndërmjet moshës 40 dhe 49 vjeç është tre herë më i lartë se për një person ndërmjet moshës 30 dhe 39 vjeç dhe 12 herë më i lartë se për një person ndërmjet moshës 20 dhe 29 vjeç. Nuk ka kurim kundër COVID-19, megjithëse disa trajtime ulin rrezikun e ndërlikimeve.

## Pse duhet të marr vaksinën kundër COVID-19?

Të rriturit e shëndetshëm janë në rrezik nga komplikimet e COVID-19 dhe rreziku është më i lartë për të rriturit e moshuar ose ata me kushte shëndetësore të caktuara. Rreth 15% të të rriturve më të rinj, duke përfshirë ata në të 20-at e tyre, kanë simptoma që mund të zgjasin me muaj pas infektimit ("COVID i gjatë"). Vaksina kundër COVID-19 mbron shumicën e njerëzve nga ndërlikimet serioze nga COVID-19.

Ne të gjithë duam që jeta të funksionojë përsëri dhe programi i vaksinimit është një hap i madh drejt kësaj. **Shumë njerëz në Uells e dinë këtë - një sondazh i kryer në vitin 2021 tregoi se rreth 80% e të rriturve më të rinj mendonin të vaksinoheshin.**

Marrja e vaksinës në pjesën e parë të programit të vaksinimit ka qenë shumë e lartë.

Në rast se dëshironi të udhëtoni jashtë vendit në të ardhmen, disa vende mund t'ju kërkojnë të tregoni prova se jeni vaksinuar. Në disa shtete normat e COVID-19 janë më të larta.

Vaksinat na ofrojnë shpresë për të kontrolluar pandeminë, por është e nevojshme që të vaksinohen sa më shumë njerëz që kjo të funksionojë më mirë. Çdo vaksinim ka rëndësi, përfshirë edhe tuajin.



**Vaksinimi është i shpejtë,  
i lehtë dhe i sigurt**

## A janë të sigurt vaksinat?

Në Mbretërinë e Bashkuar do të përdoren disa lloje të ndryshme të vaksinave kundër COVID-19. Çdo vaksinë është testuar në dhjetëra mijëra njerëz në disa vende të ndryshme. Siguria dhe efektshmëria e tyre janë vlerësuar me kujdes nga Agjencia Rregullatore e Barnave dhe Produkteve Shëndetësore (MHRA) përpara se të autorizohet përdorimi i tyre.

Në Mbretërinë e Bashkuar më shumë se 34 milion njerëz janë vaksinuar dhe kjo tashmë ka parandaluar shumë raste dhe më shumë se dhjetë mijë vdekje nga COVID-19. MHRA rishikon vazhdimisht sigurinë e vaksinave në përdorim, bazuar në të gjitha efektet anësore të raportuara nga profesionistë të kujdesit shëndetësor dhe publiku.

Kohët e fundit është raportuar për një gjendje jashtëzakonisht të rrallë e cila shoqërohet me mpiksjen e gjakut dhe gjakderdhjen e pazakontë pas vaksinimit me vaksinën AstraZeneca, e cila po shqyrtohet me kujdes.

Për shkak të rrezikut të lartë të ndërlikimeve dhe vdekjes të shkaktuara nga COVID-19, MHRA, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjencia Evropiane e Barnave kanë arritur në përfundimin se balanca ndërmjet rrezikut dhe përfitimit është në favor të vaksinimit.

Për më shumë informacion mbi përfitimet dhe rreziqet e vaksinimit kundër COVID-19 dhe mpiksjen e gjakut, shikoni në adresën: **[phw.nhs.wales/patientinfo](https://phw.nhs.wales/patientinfo)**.

## A mund t'u besojmë vaksinave që janë zhvilluar kaq shpejt?

Kërkimet dhe provat klinike të cilat janë të nevojshme për t'u siguruar se vakcina funksionon dhe është e sigurt, marrin kohë, **por gjithashtu duhet një kohë e gjatë për të siguruar financim dhe miratimin për kërkimin**. Disa gjëra kanë ndihmuar në përshpejtimin e procesit:

- Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar financoi zhvillimin e provave klinike të vaksinës kundër COVID-19 për vënien e tyre të shpejtë në përdorim
- MHRA përshpejtoi procesin e miratimit - gjëra të tilla si për shembull dokumentet administrative që dikur merrnin muaj, tani përpunohen brenda disa ditëve
- Fazat e ndryshme të provave klinike janë kryer në të njëjtën kohë
- Teknologjitë e reja kanë ndihmuar në prodhimin e shpejtë të shumë vaksinave

Ende po bëhet çdo përpjekje për të siguruar që vaksinat të funksionojnë dhe të jenë të sigurt. Pasi një vaksinë fillon të përdoret, MHRA vazhdon të hetojë mbi sigurinë e saj dhe të hetojë mbi të gjitha ngjarjet e padëshiruara që raportohen.

## A do të më mbrojnë vakcina?

Të gjitha vaksinat e miratuara janë jashtëzakonisht të efektshme në mbrojtjen e njerëzve që të mos sëmuren rëndë nga COVID-19. Studimet kanë treguar se nivelet e larta të mbrojtjes zhvillohen në një periudhë afatshkurtër dy ose tre javë pas marrjes së një dozë të vetme të vaksinës, por për shumicën e vaksinave kërkohet një dozë e dytë për mbrojtje më afatgjatë. Si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është 100% efektive - disa njerëz ende mund të marrin COVID-19 pavarësisht nëse janë vaksinuar, por kjo mendohet të jetë më pak serioze.

## A kam të drejtë të marrë vaksinën kundër COVID-19?

Tani që vaksina u është ofruar grupeve të para dhe atyre mbi 50 vjeç, JCVI ka këshilluar që në vazhdim vaksina t'u ofrohet të gjithë personave madhorë të moshës ndërmjet 18 dhe 49 vjeç, sipas grupmoshës:

- **40-49 vjeç**
- **30-39 vjeç**
- **18-29 vjeç (18 vjeç në ditën e vaksinës)**

Ju do të kontaktoheni kur të jetë koha për të marrë vaksinën tuaj.

## Unë jam shtatzënë, a mund ta marr vaksinën?

Po, në rast se jeni shtatzënë, ju duhet të merrni parasysh mundësinë e vaksinimit. Ne ju inkurajojmë që të lexoni vendimin e ndihmës mjekësore të Kolegjit Mbretëror të Obstetërve dhe Gjinekologëve në këtë link: [www.rcog.org.uk/covid-vaccine](http://www.rcog.org.uk/covid-vaccine) para se të paraqiteni në takimin tuaj për marrjen e vaksinës. Informacioni mbi ndihmën mjekësore mund t'ju ndihmojë të merrni një vendim të informuar. Në rast se keni pyetje të tjera, flisni me maminë ose Mjekun tuaj të Përgjithshëm.

Ne e dimë që shumë vaksina mund të administrohen në mënyrë të sigurt gjatë shtatzënisë, por vaksinat kundër COVID-19 nuk janë testuar tek personat shtatzënë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më shumë se 90,000 gra shtatzëna janë vaksinuar me vaksinat Pfizer dhe Moderna dhe nuk është identifikuar asnjë shqetësim mbi sigurinë. Prandaj, këto vaksina janë të preferueshme për gratë shtatzëna.

Ka edhe një fletëpalosje të veçantë: **Vaksinimi kundër COVID-19: një udhëzues për të gjitha gratë që janë duke planifikuar një shtatzëni, janë shtatzënë ose që janë duke ushqyer me gji.**

Ju nuk keni nevojë të shmangni shtatzëninë pasi të keni marrë vaksinën kundër COVID-19.

## A mund ta marr vaksinën nëse jam duke ushqyer me gji?

Përfitimet e ushqyerjes me gji janë të njohura, dhe vaksinat kundër COVID-19 nuk dihet të paraqesin ndonjë rrezik gjatë ushqyerjes me gji. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe JCVI kanë rekomanduar që vaksina mund t'u jepet grave që janë duke ushqyer me gji. Megjithatë, ne nuk kemi shumë të dhëna për sigurinë e përdorimit të vaksinave kundër COVID-19 gjatë ushqyerjes me gji. Në rast se jeni duke ushqyer me gji, ose planifikoni të ushqeni me gji, ju **mund** të vazhdoni të ushqeni me gji pas marrjes së vaksinës.

## A do të ndikojë vaksina në pjellorinë time?

Jo, nuk ka prova që sugjerojnë se vaksinat kundër COVID-19 do të ndikojnë në pjellori.

## Kush nuk mund ta marrë vaksinën?

Një numër shumë i vogël njerëzish nuk mund të marrin disa nga vaksinat kundër COVID-19. Kjo përfshin njerëzit që kanë pasur një reaksion alergjik të rëndë ndaj një prej përbërësve të vaksinës ose të një doze të mëparshme nga e njëjta vaksinë ose që kanë disa çrregullime të rralla të gjakut. Këtyre personave mund t'u ofrohet një vaksinë alternative.

Në rast se aktualisht nuk ndiheni mirë, keni ethe ose keni bërë një test i cili ka rezultuar pozitiv për COVID-19 në 28 ditët e fundit, ju duhet të rezervoni një takim më vonë.

## A ka vakcina efekte anësore?

Si të gjitha ilaçet, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Kjo ndodh sepse vaksinat funksionojnë duke shkaktuar një reagim në sistemin tuaj imunitar. Shumica e tyre janë të lehta dhe zgjasin vetëm disa ditë dhe ato nuk shfaqen tek të gjithë.

**Edhe në rast se keni simptoma pas dozës së parë, ju gjithsesi duhet të merrni dozën e dytë.**

### **Efektet anësore më të zakonshme gjatë ditës së parë ose të dytë përfshijnë:**

- ndjesinë e dhimbjes, rëndesë dhe ndjeshmëri në krahun ku është bërë injeksioni për disa ditë pas marrjes së vaksinës;
- ndjesinë e të qenit i lodhur;
- dhimbje koke;
- dhimbje të përgjithshme, ethe ose simptoma të ngjashme me gripin.

Mund të keni pak ethe gjatë dy deri tre ditë pas vaksinimit, por temperatura e lartë është e pazakontë dhe mund të tregojë se keni COVID-19 ose një infektion tjetër. Ju mund të merrni paracetamol (ndiqni këshillat për dozën dhe intervalet kohore që gjenden në paketim) dhe pushoni që të ndjeheni më mirë. Mos merrni më shumë se doza e rekomanduar.

Një efekt anësor i pazakontë është ënjtja e gjëndrave në sjetull ose në zonën e qafës në të njëjtën anë ku keni bërë vaksinën. Kjo mund të zgjasë për rreth 10 ditë, por në rast se zgjat më shumë flisni me mjekun tuaj.



Efektet anësore të zakonshme pas vaksinimit normalisht zgjasin më pak se një javë. Në rast se simptomat tuaja përkeqësohen ose jeni të shqetësuar, shikoni në adresën: **111.wales.nhs.uk** online, dhe nëse është e nevojshme telefononi NHS 111 Wales në numrin **111** ose klinikën e Mjekut tuaj të Përgjithshëm. Në rast se 111 nuk është në dispozicion në zonën tuaj, telefononi në numrin **0845 46 47**. Telefonatat për NHS 111 Uells janë pa pagesë nga linjat fikse dhe celularët. Telefonatat në numrin 0845 46 47 kushtojnë 2p në minutë plus tarifën e zakonshme të përdorimit të operatorit tuaj telefonik.



**Në rast se përjetoni ndonjë nga simptomat e mëposhtme ndërmjet rreth 4 ditë deri në four javë pas vaksinimit, ju duhet të kërkonti urgjentisht këshillë mjeksore.**

- ◆ Një dhimbje koke e re e fortë, e cila nuk largohet me qetësuesit e zakonshëm ose përkeqësohet
- ◆ Një dhimbje koke e pazakontë që duket sikur përkeqësohet kur shtriheni ose përkuleni, ose që mund të shoqërohet nga:
  - Vegim i turbullt, të përziera dhe të vjella
  - Vështirësi në të folur
  - Dobësi, përgjumje ose kriza
- ◆ Mavijosje ose gjakderdhje të reja, të pashpjegueshme nga një shpim me gjilpërë
- ◆ Gulçim, dhimbje gjoksi, ënjtje të këmbëve ose dhimbje të vazhdueshme të barkut

Në rast se keni pasur ndonjë nga simptomat e mësipërme pas dozës së parë, duhet të flisni me mjekun ose specialistin tuaj para se të merrni dozën e dytë.

**Në rast se kërkonti këshillë nga një mjek ose infermier, sigurohuni që t'u tregoni atyre rreth vaksinimit tuaj (nëse është e mundur, tregojuni kartelën tuaj të vaksinimit) në mënyrë që ata t'ju vlerësojnë saktë.**

Ju gjithashtu mund të raportoni çdo efekt anësor nëpërmjet skemës së Kartonit të Verdhë (shikoni 'Më shumë informacion').

## A mund ta marr COVID-19 nga vaksina?

Ju nuk mund ta merrni COVID-19 nga vaksina Sidoqoftë, ju mund të infektoheni me COVID-19 dhe të mos e kuptoni se keni simptoma derisa të vaksinoheni.

Simptomat më të rëndësishme të COVID-19 janë shfaqja e ndonjë prej simptomave të mëposhtme së fundmi:

- kollë e re e vazhdueshme
- temperaturë të lartë
- humbja e ndjesisë së nuhatjes ose shijes

Në rast se keni ndonjë nga këto simptoma, qëndroni në shtëpi dhe caktoni kryerjen e një testi duke telefonuar në numrin 119 (telefonatat janë pa pagesë). Disa qendra shëndetësore ofrojnë teste për një gamë më të gjerë të simptomave, prandaj kontrolloni në faqen e internetit të qendrës tuaj shëndetësore lokale për simptoma shtesë që do t'ju lejojnë të testoheni në zonën tuaj. Në rast se keni nevojë për më shumë informacion mbi simptomat vizitoni: **111.wales.nhs.uk**

## Çfarë duhet të bëj?

Ju do të merrni informacione se kur dhe ku të vaksinoheni. Në ditën e takimit tuaj, vishni rroba praktike në mënyrë që të arrihet lehtësisht në pjesën e sipërme të krahut tuaj. Në rast se keni frikë nga gjilpërat ose ndiheni të shqetësuar, njoftoni personin që ju bën vaksinën. Ata do t'ju kuptojnë dhe do t'ju mbështesin.

**Është e rëndësishme që t'i merrni të dyja dozat e vaksinës për t'ju dhënë mbrojtjen më të mirë afatgjatë.** Ruajeni kartën tuaj dhe sigurohuni që të paraqiteni në takimin tuaj të ardhshëm për dozën tuaj të dytë.

## Çfarë duhet të bëj nëse nuk ndihem mirë ditën e takimit tim të ardhshëm?

Në rast se nuk ndiheni mirë dhe keni ethe, telefononi për të anuluar takimin dhe prisni derisa ta keni marrë veten për të marrë vaksinën. Ju nuk duhet të paraqiteni në takimin për marrjen e vaksinës në qoftë se jeni vetë-izoluar ose jeni duke pritur për testin e COVID-19 ose rezultatin e testit.

# A duhet t'i ndjek udhëzimet edhe nëse jam vaksinuar?

Vaksina do të zvogëlojë mundësinë që ju të sëmureni rëndë, por nuk do t'ju mbrojë plotësisht nga infektimi dhe transmetimi i virusit. Pra, është e rëndësishme që të vazhdoni të ndiqni udhëzimet e COVID-19 për të mbrojtur ata që ju rrethojnë.

**Për të mbrojtur veten dhe familjen tuaj, miqtë dhe kolegët ju ende keni nevojë të:**

- ruani distancimin social;
- mbani një maskë për fytyrën;
- lani duart me kujdes dhe shpesh;
- vetë-izoloheni në rast se shfaqni simptoma ose jeni kontaktuar nga shërbimi Test, Trace, Protect Test, Gjurmim, Mbrojtje; dhe
- ndiqni udhëzimet aktuale në: **[gov.wales/coronavirus](https://gov.wales/coronavirus)**

## Mbani mend:

COVID-19 përhapet nëpërmjet piklave të cilat dalin nga hunda ose goja, veçanërisht kur flasim ose kollitemi. Ju mund ta merrni atë gjithashtu nëse i prekni sytë, hundën dhe gojën pasi të keni prekur objekte dhe sipërfaqe të ndotura.


### Tre rregulla për TA MBAJTUR UELLSIN TË SIGURT



Lani  
duart



Mbani një  
maskë për  
fytyrën



Mbani  
distancë

# Më shumë informacion

Ju mund të gjeni më shumë informacion në lidhje me vaksinat kundër COVID-19, përfshirë përmbajtjen e tyre dhe efektet e mundshme anësore në adresën:

**[111.wales.nhs.uk/coronavirus\(2019ncov\)](https://111.wales.nhs.uk/coronavirus(2019ncov))**  
dhe **[coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk/productinformation](https://coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk/productinformation)**

Ju mund të raportoni efektet anësore të dyshimta online në adresën: **[coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk](https://coronavirus-yellowcard.mhra.gov.uk)** ose shkarkoni aplikacionin Yellow Card.

Për të zbuluar se si NHS përdor informacionin tuaj, vizitoni faqen në adresën: **[111.wales.nhs.uk/lifestylewellbeing/yourinfoyourrights](https://111.wales.nhs.uk/lifestylewellbeing/yourinfoyourrights)**

Për formate të tjera të kësaj fletëpalosjeje duke përfshirë Easy Read, shkronja të mëdha, video e gjuhës së shenjave britanike, Recite Me accessibility software dhe gjuhë të tjera vizitoni:



**[phw.nhs.wales/covid-19-vaccination](https://phw.nhs.wales/covid-19-vaccination)**

© Shëndeti Publik Uells, Maj 2021  
(referuar Shëndetit Publik të Anglisë)

Versioni 4

ISBN : 978-1-78986-154-198

